

**02.06.2023
Ora 09:36**

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për dhënien e mandatit për kryetarë të disa bashkive për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ:** **Z. Ilirjan Celibashi,**
- **Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
- **Stafi KQZ:** **Z. Ylli Merkaj, Znj. P. Doçaj**
- **Të tjerë:** **S’ka**

Z. I. Celibashi: Mirmëngjes, atëherë në seancën e sotme publike kemi në rend dite dhënien e mandateve për kryetarë të disa bashkive si dhe shpërndarjen e mandateve për anëtarë të këshillit bashkiak, për bashkitë përkatëse respektive.

Z. Y. Merkaj: Atëherë, bazuar në nenin 19, shkronja “i” të Kodit Zgjedhor, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka shpallur fitues disa kryetarë të bashkive, duke u bazuar në numrin më të madh të votave të vlefshme, të zgjedhësve që kanë votuar në njësitë zgjedhore përkatëse, bazuar në këtë vendim KQZ-ja ka miratuar tabelat përmbledhëse të rezultatit me kandidatët fitues dhe të Bashkisë Tiranë, Durrës, Lezhë, Korçë, Vlorë dhe Bashkisë Krujë. Bazuar në nenin 19, shkronja “i” të Kodit Zgjedhor i propozojmë Komisionerit dhënien e mandatit për kryetarin e Bashkisë

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.02.06.2023*

Zgjedhor i propozojmë Komisionerit dhënien e mandatit për kryetarin e Bashkisë Tiranë, Durrës, Lezhë, Korçë, Vlorë, Krujë bazuar në tabelat përmbledhëse të rezultatit, të miratuara në KQZ, në seancë publike, bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim e miratim, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit, atëherë miratojmë:

dhënien e mandatit të kryetarit të Bashkisë Lezhë zotit Pjerin Ndreu, mbështetur nga Partia Socialiste,

dhënien e mandatit të kryetarit të Bashkisë Durrës zonjës Emirjana Sako e mbështetur nga Partia Socialiste e Shqipërisë,

dhënien e mandatit të kryetarit të Bashkisë Tiranë zotit Erjon Veliaj mbështetur nga Partia Socialiste e Shqipërisë,

dhënien e mandatit të kryetarit të Bashkisë Korçë zotit Sotiraq Filo mbështetur nga Partia Socialiste e Shqipërisë,

dhënien e mandatit të kryetarit të Bashkisë zotit Ermal Dredha mbështetur nga Partia Socialiste e Shqipërisë,

dhënien e mandatit të kryetarit të Bashkisë Krujë zotit Artur Bushi mbështetur nga Partia Socialiste e Shqipërisë.

Vendimi nr. 643 - 648

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



02.06.2023
Ora 09:38

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për shpërndarjen e mandateve ndërmjet subjekteve zgjedhore për Këshillin e Bashkisë Durrës, Pukë, Përmet, Gjirokastrë, Memaliaj, Dibër për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.


PJESËMARRJA :

- **KQZ:** Z. Ilirjan Celibashi,
- **Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaç, Znj. P. Doçaj
- **Të tjerë:** S’ka

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me projektvendimet që lidhen me shpërndarjen e mandateve për kryetarë këshilli për këto bashki.

Z. Y. Merkaç: Bazuar në nenin 19, pika “i” të Kodit Zgjedhor Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miraton shpërndarjen e mandateve në zgjedhjet për këshillat vendor, si dhe mandatet për çdo kryetar bashkie territorit i cili ndahet në më shumë se një KZAZ, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve ka miratuar tabelën përmbledhëse të rezultateve të Bashkisë Durrës, Krujë, Pukë, Përmet, Gjirokastrë, Memaliaj, Dibër dhe Divjak, edhe kundër këtij vendimi nuk është bërë ankim brenda afatit ligjor të parashikuar nga ligji, rezultati për këshillat bashkiak renditja e subjektit dhe shpërndarja e mandateve është bërë në bazë të nenit 162, pika 2,4 dhe 5 e Kodit

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.02.06.2023*

Zgjedhor, sipas nenit 163, pika 1 dhe 166 pika 3, e Kodit Zgjedhor menjëherë pas përfundimit të llogaritjes së rezultatit për sa më sipër KQZ po llogarit shpërndarjen e mandateve për kandidatët fitues për secilin subjekt në bazë të renditjes në listat shumëemërore të subjekteve zgjedhore të miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim e miratim si dhe tabelat përmbledhëse të rezultateve të Bashkisë: Durrës, Krujë, Pukë, Përmet, Gjirokastrë, Memaliaj, Dibër.

Z. I. Celibashi: Faleminderit, atëherë vendosim shpërndarjen e mandateve për subjektin zgjedhor, për zonën zgjedhore Bashkia Durrës si më poshtë:

Koalicioni Bashkë Fitojmë 13 mandate,

Partia Socialiste e Shqipërisë 28,

Partia Agrare Ambjentaliste 3,

Partia Socialdemokrate 1,

Partia Demokratike 5,

Partia Drejtësi dhe Integrim 1 mandat.

Për Bashkinë e Krujës shpërndarja e mandateve është si vijon:

Për Koalicionin Bashkë Fitojmë 5 mandate,

Partia Socialiste e Shqipërisë 11,

Partia Agrare Ambjentaliste 3,

Partia Republikane 1,

Partia Socialdemokrate 2,

Partia Demokratike 2,

Fryma e Re Demokratike 1,

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.02.06.2023*

Partia e Gjelbër 3 dhe Ardhmëria Shqipëtare 3 mandate.

Kemi Bashkinë Pukë, shpërndarja e mandateve për anëtarë të këshillit në Bashkinë Pukë është si vijon:

Koalicioni Bashkë Fitojmë ka 1 mandat,

Partia Socialiste e Shqipërisë 2 mandate,

Partia Demokracia Sociale 1 mandat,

Partia Socialdemokrate 4 mandate,

Partia Demokratike 1 mandat,

Fryma e Re Demokratike 1 mandat,

Partia Aleanca e Shqipërisë 1 mandat,

Aleanca Arbnore Kombëtare 2 mandate,

Partia Balli Kombëtar 1 mandat dhe Froti Majtë ka 1 mandat Bashkinë Kukës.

Bashkia Përmet, shpërndarja e mandateve për anëtarë të këshillit në Bashkinë Përmet është si vijon:

Koalicioni Bashkë Fitojmë ka 1 mandat,

Partia Socialite e Shqipërisë 9 mndate,

Partia Lëvizja e Legalitetit 1 mandat,

Partia Social Demokrate 2 mandate,

Partia Demokratike 1 mandat,


Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane 1 mandat.

Për këshillin e Bashkisë Gjirokastër shpërndarja e vendeve në Këshill apo e mandateve është si vijon:

Koalicioni Bashkë Fitojmë 5 mandate,

Partia Socialiste e Shqipërisë 21,

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.02.06.2023*

Partia Republikane 1 mandat,
Partia Socialdemokrate 1 mandat,
Partia Demokratike 2 mandate dhe Partia Aleanca Arbnore Kombëtare 1 mandat.
Për Bashkinë Memaliaj shpërndarja e vendeve në Këshill është si vijon:

Koalicioni Bashkë Fitojmë ka 3 vende në këshill,
Partia Socialiste e Shqipërisë 7,
Partia Agrare Ambientaliste 1,
Partia Demokracia Sociale 1,
Partia Socialdemokrate 1 dhe Partia Demokratike 2.

Në këshillin e Bashkisë Dibër shpërndarja e mandateve është si vijon:

Koalicioni Bashkë Fitojmë ka 5 mandate,
Partia Socialiste e Shqipërisë 13,
Partia Agrare Ambientaliste ka 1,
Partia Republikane 1,
Partia Lëvizja e Legalitetit 1,
Partia Social Demokrate 6,
Fryma e Re Demokratike 1,
Partia Demokratike 1,
Partia Aleanca Demokristiane 1 dhe kandidati i mbështetur nga zgjedhësit zoti Astrit Ademi ka fituar dhe ai 1 mandat në Këshillin e Bashkisë Dibër.

Vendimi nr. 649 - 655

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



02.06.2023
Ora 09:43

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për korigjimin e gabimit material në vendimin nr. 549, datë 23.05.2023, “Për shpërndarjen e mandateve ndërmjet subjekteve zgjedhore për Këshillin e Bashkisë Divjakë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”].

PJESËMARRJA :

- **KQZ:** Z. Ilirjan Celibashi,
- **Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. P. Doçaj
- **Të tjerë:** S’ka

Z. I. Celibashi: Në këshillin e Bashkisë Divjakë....kemi korigjimin e vendimit do të thoja.

Z. Y. Merkaj: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin 549 datë 23.05.2023 ka shpallur kandidatin fitues nga lista shumemërore e subjekteve zgjedhore të miratuara nga Komisioni i Administrimit Zgjedhor për këshillin e Bashkisë Divjakë. Partia Socialiste me shkresën e datës 26.05.2023 ka informuar KQZ-në se ka konstatuar një pasaktësi në pikën 2, të vendimit të mësipërm, konkretisht lista e kandidatëve të shpallur fitues nuk përputhet me listën e regjistruar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste në KZAZ numër 56 Bashkia Divjakë, ku zoti Xhorxh

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.02.06.2023*

Mitro Kruti është renditur i 12 në listën shumemërore të regjistruar në KZAZ dhe nuk rezulton të jetë i renditur në 18 kandidatët fitues të shpallur nga KQZ-ja me vendimin numër 549 datë 23.05.2023 duke qënë se kemi këtë pasaktësi i referohemi nenit 112 të Kodit të Procedurave Administrative ku përcaktohet se organi publik në çdo kohë, kryesisht ose me kërkesë mund të korigjojë gabimimet e shkrimit, gabimet në përllogaritje ose pasaktësi të tjera të dukshme në një akt administrativ, për këtë arsye bazuar në nenin 11 pika 1 shkronja 'n' dhe pika e 2 e Kodit Zgjedhor, i propozojmë Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve korigjimin e gabimit të material në pikën 2, të vendimit 549 datë 23.05.2023 të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve për shpërndarjen e mandateve ndërmjet subjekteve zgjedhore në këshillin e Bashkisë Divjakë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas pikës 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi, bashkëlidhur kemi projektvendimin për shqyrtim e miratim, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit, mirë atëherë bëjmë korigjimin e gabimit material, në pikën 2, të vendimit 549 datë 23.05.2023 Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për shpërndarjen e mandatit ndërmjet subjekteve zgjedhore për këshillin e Bashkisë Divjak, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Mirë, çështje të tjera nuk kemi seanca mbyllet, ditë të mbarë.

Vendimi nr. 656

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*

